



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
MINISTRIA E ARSIMIT  
DHE SPORTIT

Drejtoria e Arsimit Parauniversitar

Nr. 2477 Prot.

Tiranë, më 08 4 2014

**LËNDA:** DËRGOHET UDHËZUESI PËR NXJERRJEN E NOTËS VJETORE LËNDORE  
DHE TË NOTËS MESATARE VJETORE (KLASAT IV-IX)

**DREJTUAR:** DREJTORISË ARSIMORE RAJONALE

ZYRËS ARSIMORE

Bashkëlidhur ju dërgojmë udhëzuesin për nxjerrjen e notës vjetore lëndore dhe të notës mesatare vjetore (klasat IV-IX).

Merrni masa që me udhëzuesin të pajisen të gjitha drejtoritë e shkollave 9-vjeçare dhe të njihen me këtë udhëzues të gjithë mësuesit e arsimit bazë.

DAR/ZA-të të mbështesin dhe të monitorojnë procesin e nxjerrjes së notës vjetore lëndore dhe të notës mesatare vjetore në klasat IV-IX në përputhje me këtë udhëzues.

PLARENT NDRECA

SEKRETAR I PËRGJITHSHËM



**U D H Ë Z U E S**  
**PËR NXJERRJEN E NOTËS VJETORE LËNDORE**  
**DHE TË NOTËS MESATARE VJETORE**  
**(KLASAT IV-IX)**

**I. NOTAT LËNDORE**

**Sipas pikës 3 të nenit 17** të Dispozitave Normative (DN), *“Në arsimin bazë pas klasës III, ..., nxënësi vlerësohet për: a) një ose disa tema mësimore të sapozhvuilluara; b) një ose disa kapituj të tekstit të nxënësit; c) projekte ndërlëndore/lëndore”*.

**Shkronja a)** *“një ose disa tema mësimore të sapozhvuilluara”* nënkupton që nxënësit vlerësohen për përvetësimin e mësimin të ditës ose të pak orëve të mëparshme. Mësuesi përdor mënyra të ndryshme për këto vlerësime me notë, si përgjigjet nxënësve me gojë ose me shkrim me të gjithë nxënësit e klasës ose me një pjesë të klasës etj. (Sipas pikës 11 të nenit 17 të DN, *“Vlerësimet e shkurtra (minitestet), nga fundi i orës mësimore, për rendimentin e orës mësimore ose të një kapitulli, nuk vlerësohen me notë”*.)

**Shkronja b)** *“një ose disa kapituj të tekstit të nxënësit”* nënkupton notat e provimeve të zakonshme në fund të një ose më shumë kapitujve të tekstit. Këtu përfshihen edhe notat që marrin nxënësit në testimet nga drejtorja e shkollës dhe nga vlerësues të jashtëm, kur rezultatet hidhen në regjistër.

**Sipas pikës 3 të nenit 18** të DN, *“Notat e nxënësve në provimet me short përfshihen në vlerësimin për një ose disa kapituj të tekstit të nxënësit”*. *“Përgjigjet e nxënësve ruhen në arkivin e shkollës për 2 vjet dhe janë objekt i inspektimit nga IShA”* (pika 4, neni 18). Drejtorja e shkollës i harton testet për provimet me short në bashkëpunim me mësuesin e lëndës. Zhvillimi i testit nuk bëhet nga mësuesi i lëndës, por organizohet nga drejtorja. Në vlerësimin e përgjigjeve të nxënësve merr pjesë jo vetëm mësuesi i lëndës.

**Pika 12 e nenit 17**, *“Notat që nxënësit marrin në testimet, të cilat nuk kryhen nga mësuesit lëndorë, nuk hidhen në regjistër”*, **nuk bie ndesh me pikën 3 të nenit 18**, duke pasur parasysh se testi i provimit me short, që zhvillohet nga drejtorja, do të hartohet në bashkëpunim me mësuesin e lëndës që i ka rënë shorti. Nëse nuk bëhet kështu, drejtorja mund të hartojë një test me vështirësinë e të cilit mund të mos jetë dakord mësuesi lëndor dhe, për rrjedhojë, nuk do të pranojë as rezultatit e provimit, pra, as përgjegjësinë e rezultatit të dobët. Kurse provimi që zhvillon DAR/ZA-ja, pika 5 e nenit 18, nuk përfshihet në notat e nxënësve.

**Sipas pikës 10 të nenit 17** të DN, *“Provimet me shkrim të nxënësve ruhen nga mësuesi për 1 (një) vit shkollor dhe janë objekt i inspektimit nga IShA, që shqyrton përputhjen me programin lëndor dhe objektivitetin e vlerësimit”*.

**Sipas pikës 5 të nenit 17 të DN, "Mësuesi lëndor, sipas lëndës: ...b) ndan afërsisht barabar të dy llojet e vlerësimeve (3a dhe 3b)."**

**Shkronja c)** "projekte ndërlëndore/lëndore" nënkupton notën/notat që merr nxënësi për projekte lëndore ose ndërlëndore.

**Sipas pikës 4 të nenit 17 të DN, "Nxënësi vlerësohet në çdo lëndë të paktën një herë gjatë vitit shkollor për projekt ndërkurrikular/kurrikular. Orët mësimore për projektet u takojnë orëve të parashikuara në programin lëndor për përpunimin e njohurive".**

Në programet mësimore aktuale të lëndëve, 10%-25% e orëve vjetore kanë emrin "Orë të lira". Këto përdoren kështu nga mësuesit: 1/3 e përdor mësuesi për përforsim, kurse pjesën tjetër për projekte lëndore ose ndërlëndore ose veprimtari të tjera, si testime nga drejtoria. Kështu, një pjesë e orëve mësimore është posaçërisht për projekte kurrikulare. Del se në një lëndë me 3 orë në javë, mësuesi duhet të planifikojë 3-5 orë në vit për projekte kurrikulare (mundet edhe më shumë).

## II. NOTA VJETORE LËNDORE NË FILLORE (KLASAT IV-VI)

Nota vjetore lëndore e nxënësve të klasave IV-VI llogaritet si mesatare aritmetike e të gjitha notave që nxënësi ka marrë gjatë vitit mësimor.

## III. NOTA VJETORE LËNDORE NË ARSIMIN E MESËM TË ULËT (KLASAT VII-IX)

Llogaritja e notës vjetore lëndore bëhet sipas pikës 9 të nenit 17 të DN, e cila thotë:

"Në arsimin e mesëm të ulët ...nota vjetore lëndore e nxënësit përlllogaritet nga mësuesi i lëndës me formulën:

*Nota vjetore lëndore =  $0,4 \times M_1 + 0,5 \times M_2 + 0,1 \times M_3$ , ku  $M_1, M_2, M_3$  janë përkatësisht mesataret aritmetike të vlerësimeve për pikat 3/a, 3/b dhe 3/c, të pikës 3 të këtij neni, të rrumbullakosura me një shifër pas presjes."*

### Shembulli i parë

Një nxënës ka marrë këto nota gjatë vitit shkollor:

- a) Notat për një ose disa tema mësimore: 6, 7, 9.
- b) Notat për një ose disa kapituj tekstit: 8, 5, 4.
- c) Notat për projektet lëndore/ndërlëndore: 5, 6.

### Hapi i parë:

Në fillim llogarisim vlerat e  $M_1, M_2$  dhe  $M_3$ , duke pasur parasysh që mesataret t'i rrumbullakosim me një shifër pas presjes:

$$M_1 = (6 + 7 + 9) : 3 = 22 : 3 = 7,3$$

$$M_2 = (8 + 5 + 4) : 3 = 17 : 3 = 5,7$$

$$M_3 = (5 + 6) : 2 = 11 : 2 = 5,5$$

#### Hapi i dytë:

Pastaj llogarisim notën lëndore vjetore.

$$\begin{aligned} \text{Nota vjetore lëndore} &= 0,4 \times M_1 + 0,5 \times M_2 + 0,1 \times M_3 = \\ &= 0,4 \times 7,3 + 0,5 \times 5,7 + 0,1 \times 5,5 = 2,92 + 2,85 + 0,55 = 6,32 \end{aligned}$$

**Nota vjetore është 6.** (Po të gjenim mesataren e të gjitha notave, do të dilte 7)

#### **Shembulli i dytë**

Një nxënës ka marrë këto nota gjatë vitit shkollor:

- Notat për një ose disa tema mësimore: 6, 7, 8, 8, 8, 9.
- Notat për një ose disa kapituj tekstit: 5, 6, 6, 7, 6.
- Nota për projektet lëndore/ndërlëndore: 7.

#### Hapi i parë:

Llogariten mesataret e notave për grupnotat e mësipërme a), b) dhe c).

$$M_1 = (6 + 7 + 8 + 8 + 8 + 9) : 6 = 46 : 6 = 7,6$$

$$M_2 = (5 + 6 + 6 + 7 + 6) : 5 = 30 : 5 = 6$$

$$M_3 = 7$$

#### Hapi i dytë:

Llogaritet nota vjetore e lëndës.

$$\begin{aligned} \text{Nota vjetore lëndore} &= 0,4 \times M_1 + 0,5 \times M_2 + 0,1 \times M_3 = \\ &= 0,4 \times 7,6 + 0,5 \times 6 + 0,1 \times 7 = 3,04 + 3 + 0,7 = 6,74 \end{aligned}$$

**Nota vjetore është 7.** (Po të gjenim mesataren e të gjitha notave, do të dilte 7)

#### **Shembulli i tretë**

Një nxënës ka marrë këto nota gjatë vitit shkollor:

- Notat për një ose disa tema mësimore: 8, 10, 10, 10, 10, 10.
- Notat për një ose disa kapituj tekstit: 7, 8, 7, 8.
- Nota për projektet lëndore/ndërlëndore: 7.

#### Hapi i parë:

Llogariten mesataret e notave për grupnotat e mësipërme a), b) dhe c).

$$M_1 = (8 + 10 + 10 + 10 + 10 + 10) : 6 = 58 : 6 = 9,3$$

$$M_2 = (7 + 8 + 7 + 8) : 4 = 30 : 4 = 7,2$$

$$M_3 = 7$$

#### Hapi i dytë:

Llogaritet nota vjetore e lëndës.

$$\text{Nota vjetore lëndore} = 0,4 \times M_1 + 0,5 \times M_2 + 0,1 \times M_3 =$$

$$= 0,4 \times 9,3 + 0,5 \times 7,2 + 0,1 \times 7 = 3,72 + 3,6 + 0,7 = 8,02$$

**Nota vjetore është 8.** (Po të gjenim mesataren e të gjitha notave, do të dilte  $8,6 = 9$ )

### **RASTE TË VEÇANTA**

Meqenëse ka lëndë që nuk kanë provime, situata është dy llojesh:

#### **Rasti i parë:**

Nxënësi ka notë në projektet lëndore/ndërlëndore. Në këtë rast, formula për nxjerrjen e notës vjetore lëndore është:

$$M = 0,9 \times M_1 + 0,1 \times M_3$$

#### **Shembull**

Notat për  $M_1$ : 10, 8, 9, 8, 10, 9.

$$M_1 = 54 : 6 = 9$$

Notat për  $M_3$ : 6, 6.

$$M_3 = 12 : 2 = 6$$

$$M = 0,9 \times 9 + 0,1 \times 6 = 8,1 + 0,6 = 8,7 = 9$$

**Nota vjetore është 9.** (Po të gjenim mesataren e të gjitha notave, do të dilte  $8,2 = 8$ ).

#### **Rasti i dytë:**

Nuk ka nota as në projekte kurrikulare.

Ky është rasti kur mësuesi nuk ka zbatuar programin lëndor.

Nxirret notë mesatare si mesatarja aritmetike e të gjitha notave vjetore.

#### **Shënimi 1.**

Këto llogaritje mund të kryhen më lehtë në *Excel*.

#### **Shënimi 2.**

Kjo mënyrë e nxjerrjes së notës vjetore quhet e ponderuar. Notat nuk kanë të njëjtën peshë. Një notë për mësimin e ditës nuk krahasohet për nga rëndësia me notën që merret për një kapitull, p.sh., prej 10 orësh mësimore.

Përfshirja në llogaritjen e notës vjetore edhe e notave të projekteve kurrikulare është një hap i mirë drejt të mësuarit jo vetëm nëpërmjet tekstit, por duke vëzhguar dukuri natyrore ose shoqërore, si dhe duke kërkuar burime të tjera informacioni, si: interneti, libra të tjerë, revista, buletine etj.

Nga ana tjetër, duke mos i dhënë të njëjtën peshë notës për pak orë mësimore me notën për një kapitull, mundësohet shmangia e një abuzimi të kahershëm. Mësuesi i vë një nxënësi një notë 10 me gojë, kurse në provimin e kapitullit nxënësi merr 6 dhe mesatarja i del kështu 8, kurse duke i dhënë peshë më të madhe notës së kapitullit, mesatarja, në këtë rast, ulet dhe del 7.

Gjithashtu, duke u dhënë më shumë peshë provimeve të kapitullit, pritet që nxënësit të shtrëngohen të mësojnë sistematikisht, pasi vetëm kështu mund të marrin notë të lartë në provim.

#### IV. NOTA MESATARE E NXËNËSIT PËR NJË VIT SHKOLLOR (KLASAT IV-IX)

Në pikën 4 të nenit 48 të ligjit nr. 69/2012, datë 21.06.2012 "Për sistemin arsimor parauniversitar në Republikën e Shqipërisë", përmendet nota mesatare për një vit shkollor për një nxënës:

*"4. Rregullat e ...notës së tij mesatare për një vit shkollor ... përcaktohen me udhëzim të ministrit."*

**Sipas pikës 13 të nenit 17 të DN, "Mësuesi i ciklit fillor ose mësuesi kujdestar ... njehtojnë mesataren e notave vjetore të të gjitha lëndëve të çdo nxënësi. Mesatarja vjetore njehtohet me një shifër pas presjes."**

Ndërsa, si përherë, nota vjetore lëndore është numër i plotë, nga nota 4 deri te nota 10, nota mesatare vjetore e një nxënësi është e rrumbullakosur me një shifër pas presjes dhjetore. Kjo mesatare llogaritet për të gjitha lëndët të cilat kanë notë vjetore.

Mesatarja e notave vjetore të të gjitha lëndëve sintetizon arritjet e një nxënësi gjatë një viti shkollor. Nota mesatare vjetore, e rrumbullakosur me një shifër pas presjes, do të vendoset në regjistër dhe në dëftesë.

#### Shembull

|    |                                 |            |
|----|---------------------------------|------------|
| 1  | Gjuhë amtare (Gjuhë shqipe)     | 8          |
| 2  | Gjuhë e huaj                    | 7          |
| 3  | Matematikë                      | 7          |
| 4  | Fizikë                          | 8          |
| 5  | Kimi                            | 7          |
| 6  | Biologji dhe edukim shëndetësor | 9          |
| 7  | Histori                         | 10         |
| 8  | Gjeografi                       | 9          |
| 9  | Edukatë shoqërore               | 10         |
| 10 | Edukim figurativ                | 9          |
| 11 | Edukim muzikor                  | 9          |
| 12 | Aftësim teknologjik             | 8          |
| 13 | Edukim fizik                    | 10         |
| 14 | Informatikë                     | 8          |
|    | <b>Nota mesatare vjetore</b>    | <b>8,5</b> |